

NAMIK DOKLE  
**LULET E SKAJBOTËS**  
ROMAN

---

BOTIMET TOENA



NAMIK DOKLE

# Lulet e skajbotës

roman

BOTIMET TOENA  
Tiranë, 2017

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Anrila Spahija

Korrektore letrare: Petrina Ago

Përkujdesja grafike: Elida Stafa

Kopertina: Albana Kura Gega

ISBN 978-9928-235-49-7

© Autori dhe Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

E-mail: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)

[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

*Gora oborena,  
Do sërce izgorena.*

*Gora e rrënuar,  
zemrën përvëluar.*

*Këngë gorane*



Katër burra e ngritën arkëmortin mbi supe. Ende nuk i kishin bërë dy hapa drejt derës, kur dhoma e të vdekurit u thye në mijëra copëra të qelqta nga vajulurima e një vajze.

“Jo, joooo! Dua ta shoh edhe një herë! Mos ma merrni... mooos!”

Ishte motra binjake e të vdekurit.

Katër burrat nuk lëvizën nga vendi, kishin ngrirë me vdekjen ndër duar.

Ndërsa gratë dukeshin si të marmarosura prej zanave të malit.

Kufomën e kishin sjellë nga një shtet i huaj, një ditë më parë, në të errur.

“Mirë është ta varrosim sa më shpejt, ka ndërruar dy avionë deri në Shqipëri”, thanë ata që e sollën.

Por babai i tij e mbajti gjithë paraditen e ditës tjetër për t’i bërë nderet e fundit djalit të vetëm. Kishte nëntë vjet pa e parë, qëkurse u fut në njërën nga ambasadat, bashkë me mijëra të tjerë që donin të largoheshin nga vendi. Vetëm tre vjet pasi ishte larguar, u dërgoi një letër, ku shkruante pak fjalë: “Jam mirë, punoj në prishjen e shtëpive të vjetra, më ka marrë malli...”. Adresë nuk u dha, sepse, si thoshte, ndërroj shpesh punën dhe vendin e banimit. Shkruante se edhe për të ardhur nuk vij dot, akoma nuk m’i kanë rregulluar letrat. “Të mallkuarat letra! - tha i ati kur vajza po ia lexonte fjalët e të vëllait. - I lanë djemtë të ndarë për së gjalli!”

Por shpresa se do ta shihnin një ditë nuk i lëshoi asnjëherë, deri në atë buzëmbremje që ua sollën në arkëmort.

Kur dëgjoi piskamën e së bijës, babai u troshit si kalli i tejtharë. U afrua, u përpoq ta bindte të bijën të qetësohej, por ajo vazhdonte të bërtiste e të përpëlitej rreth të vdekurit.

Një grimëherë mbeti ndërdyshas, me frymë të pakërruar: prekte herë vajzën dhe herë drurin e lëmuar, ku mendonte se gjendej djali i tij. Duart i dridheshin, por gjuha i kishte ngrirë dhe nuk gjente dot asnjë fjalë për t’ua thënë atyre njerëzve që po e zhbironin syshkyem. Nga ajo zgafellë dhimbjeje dhe hutimi e nxori vëllai i tij i madh, Ismen Kallabaku, një ndër më pleqtë e katundit, i cili me një zë, që shumëkujt iu duk se po dilte nga ai arkëmort i ndalur në mes të udhëtimit për një botë tjetër, tha:



“Hapeni! Nuk mund t’i ndalohet motrës të shohë vëllanë”.

“Mirëzeza motër, çfarë do të shohë!”, tha e zimtuar njëra nga vajtojcet, duke përqsatur me fjalën e saj të kundërtën e emrit të vajzës. Të tjerat zunë ejkamën.

Jetmira i kishte terruar sytë duke pritur të shihte vëllanë e vdekur.

Katër burrat e ulën në tokë dhe pas pak njëri prej tyre me daltë dhe me çekiç u përpoq ta hapte arkën e vdekjes. Çdo goditje e veglave të metalta mbi dërrasën e lustruar e bojëkafe ngulej pa mëshirë në trutë e motrës që priste ta shikonte vëllanë e vdekur, që për nëntë vjet nuk kishte mundur ta shihte të gjallë. Babai i vrantuar dhe gjithë të tjerët më shumë shikonin atë sesa arkëmortin.

“Kujdes, me ngadalë se e vret!”, thirri ajo në një faftë kohe, kur dërrasat kishin filluar të kërcisnin.

“Çohu i dekun, se po të presin të gjallët”, tha idhshëm Ismen Kallabaku. Në atë grimëkohë u hap kapaku dhe njerëzia përreth kufomës panë lemerinë në sytë e rrëmishtë të motrës.

“Nuk është Petriti, nuk është vëllai im, jooo!”

Për t’u siguruar vetë, por edhe për të bindur të tjerët, me dorën që i dridhej si degë shelgu, ajo e preku lehtas në qafë, prapa veshit.

“Nuk është, babë, nuk e ka nishanin.”

Edhe i ati u përkul dhe e preku po aty kufomën.

“Nuk është djali im, - tha me një zë sikur po fliste për herë të fundit në këtë botë. - Mortën e kujt më keni sjellë në shtëpi?”, pyeti zhbirueshëm dy punonjësit e

kompanisë AVE, që merrej me ato punë. Në fillim askush nuk e dinte pse quhej ashtu dhe mendonin se e kishte marrë atë emër nga lutja “Ave, Maria!”, por kur pyeti një kureshtar, u kuptua se ajo quhej Agjencia e Varrimit të Emigrantëve.

“O Zot, si ka mundësi? - ngritën supet ata. - A e ka emrin Petrit djali juaj, Petrit Kallabaku, apo jo?”, dhe filloi t’i këqyrte fletët shoqëruese të të vdekurit.

Rrahën telefonat me tel e pa tel e, më në fund, u mor vesh se në atë krahinë kishte edhe tre të tjerë me emrin Petrit Kallabaku. “Paskan vjedhur mbiemrat e njëri-tjetrit”, mendoi njëri nga ata të Agjencisë së Varrimit të Emigrantëve, por dikush i shpjegoi se ai qe emri i bjeshkës dhe kushdo mund ta përdorte për mbiemër, meqë ishte pronë e gjithkujt.

U dyndën njerëz nga të tria fshatrat, një i afërt e dy të largëta, për të parë e kujt ishte ajo kufomë, që kishte mbetur e mjeruar në një shtëpi të huaj. Grupi i dytë i të ardhurve njohu njeriun e vet dhe e morën për ta vajtuar edhe një herë e për ta varrosur atje ku preheshin të parët e tij.

Kur erdhi grupi i tretë, shtatë a tetë burra, një anamend i fshatit u tha: “Erdhët vonë, vdekjen e morën të tjerët”.

E panë me inat, por i treguan se ai i shkreti kishte mbetur me shtatë dërrasa mangët, prandaj fliste ashtu. U ulën dhe pinë kafë në familjen me të cilën mbanin të njëjtin mbiemër, por që nuk ishin njohur kurrë më parë.

“Për të mirë pas sodit”, thanë shumica prej tyre.

“Po, po, - tha Ismeni, - sa po duket, Petriti ynë gjallë është, por ama orëngrimë dhe orëdekun.”

“Dashtë Zoti e nuk cokat më mortja në shtëpinë tënde!”, tha ai që e la i fundit filxhanin e dukej se ishte i pari i fjalës për ata që erdhën të merrnin vdekjen. Por ajo kishte trokitur diku tjetër.

“Çfarë drej humbëtire!”, mendonin në kthim njerëzit e Agjencisë së Varrimit të Emigrantëve. Gjithë atë natë kishin qëndruar me burrat që pinin kafë dhe duhan për të ngushëlluar babanë, që kishte arkëmortin në mes të dhomës, pa e ditur se ai nuk qe djali i tij. Njërin prej tyre po e vinte gjumi përfund, por u zhdremit kur dëgjoji xhaxhanë e të vdekurit të thoshte se ata të gjithë, që jetonin nën atë mal dhe mes dy lumenjve, janë të mallkuar.

“Na ndjek mallkimi në jetë dhe në vdekje!”

“Edhe pas vdekjes, o Ismen Kallabaku! - tha një tjetër. - Mbrapshtinë pas mbrapshtine.”

“Më e madhja ndër të këqijat, është e keqja që nuk ta zënë për të keqe”, tha Ismeni, por këto fjalë i erdhën shumë të çuditshme atij të Agjencisë së Varrimeve dhe nuk pyeti për kuptimin e tyre.

“Çfarë dreq humbëtire!”, mendoi dhe u injorua në një qoshe të dhomës. Edhe të nesërmen, gjatë gjithë rrugës së kthimit, thoshte pazëshëm po ato fjalë:

“Çfarë dreq humbëtire!”.

Ashtu siç ishte vendosur, në udhëkryqin e dy lumenjve dhe të maleve, nga ku pikaderdheshin rrufetë, dukej sikur një dorë e panjohur e kishte vënë në pirusti për ta zharritur. Të tjerë thoshin se kur Zoti kaloi atypari, duke fluturuar nga mali në mal, Gora i ra nga dora dhe mbeti aty ku është edhe sot. Ata shqetësoheshin nga kjo pakujdesi e Zotit, por inatin e kishin me djallin, që u punoi rrengun e frikës së përtjetshme.

Ismen Kallabaku tregonte se shumë e shumë vite më parë, të shtrënguar në trekëndëshin e perustisë, goranët menduan të çlirohen sadopak duke ndërtuar një urë në njërin nga lumenjtë që e rrethonin nga lindja dhe nga veriperëndimi. U rropatën tre breza me radhë për të mbledhur një grusht florinj dhe më në fund i dhanë karar të thërrisnin Mjeshtrin e urave, që i kishte shkuar zëri ku lind e ku perëndon. Përveç parave, ai kërkoi edhe shtatë mijë vezë për të lidhur gëlqeren dhe rërën me të bardhën e tyre.

“Do të bëhet më e fortë edhe se Ura e Vezirit”, tha.

Por gjithçka shkoi së prapthi. Si në të gjitha legjendat e urave, edhe ajo e Gorës, ditën ngrihej e natën prishej. Një ditë e një javë, shkuan gjashtë muaj dhe ura nuk po mbaronte.

“Na mashtrove, - i thanë Mjeshtrit. - Na mashtrove me vezë e me florinj.”

Atij i ra mali mbi kokë, iu tringuan duar e këmbë dhe iu derdh gjithë lumi në sy. Nuk foli, por ndajnatë mori një litar dhe u nis të varej në gorricën më të afërt.

“Kurrë dhe askush nuk më ka quajtur mashtrues”, mendoi. Kur po hidhte litarin në degën e gorricës, dikush ia tërhoqi lart. Mjeshtri ngriti sytë, pa në majë të pemës një fytyrë që iu duk disi e njohur.

“Kush je, pse nuk më lë të vdes?”, e pyeti.

“Pse të vdesësh?”, i tha i panjohuri.

“Gjithçka duroj, por turpin jo”, i tha Mjeshtri.

“Në do të shpëtosh, të shpëtoj unë.”

“E si më shpëtuaqe?”

“Ma shit shpirtin tënd dhe nesër në mëngjes ura është e mbaruar.”

“Aa, qenke Djalli?! Ti ma paske prishur urën në këtë agshol dimri.”

“Më njohe më në fund.”

Mjeshtri nuk u mendua gjatë.

“Sapo të lindë dielli, e dua të mbaruar urën. Sikur edhe një gur t’i mungojë, basti është i prishur.”

“U krye, - tha Djalli, - takohemi nesër në të lindur të diellit, në kulm të harkut të urës.”

Të nesërmen, me të zbardhëlluar dielli, të gjithë ishin mbledhur tek ura, që me të vërtetë dukej më e bukur se Ura e Vezirit. Ajo ishte vetëm me një hark, po ku e ku më i hijshëm se pesë harqet e Vezirit. Dukej sikur edhe dielli do të përbirohej nën të. Mjeshtri, i

bredhur nëpër Europë, kujtoi si ëndrras historinë e Mjeshtrit të Mjeshtëreve, që pati ndërtuar një katedrale të mrekullueshme në Firence dhe pas kësaj e thirrën në Romë për të ngritur Bazilikën e Vatikanit. U ndal para katedrales së tij të vogël dhe tha:

*“Vado a Roma a far la tua sorella,  
di te più grande, ma no piu bella”.*

Kështu i dukej edhe atij ura e vogël me një hark, e fundmja e syrit dhe mendjes së tij.

Një thirrje nga poshtë harkut e trazoi nga mendjeidhta që e kishte zënë.

“Ka ra një gur i qemerit!”, thirrën. Një fshatar erdhi kacaturr te Mjeshtri.

“Ka ra një gur i qemerit!”, përsëriti.

Ai zbriti frik e frik dhe pa se vërtet një gur i qemerit të urës mungonte. U fut në ujë për ta kërkuar, por i panjohuri i gorricës dhe i litarit e ndali.

“Mos kërko kot, - i tha. - Nëntëqind djajtë e mi e ngritën urën për një natë dhe ai engjëlli yt hoqi një gur e ta shpëtoi shpirtin. Por në këtë botë do të jemi përsëri bashkë, do të shihemi”, tha Djalli dhe u largua.

Gjithë zemërimin që pati me Mjeshttrin dhe Engjëllin, ia lëshoi përmbi shpinë Gorës. Zuri grykat dalëse të lumenjve që të shpërthenin ujërat nga gjoksi i malit dhe ta fshinte me çati e me themel. Por Mjeshtri i urave nuk e braktisi, punoi ditë, javë, muaj derisa e lidhi malin me rrathë çeliku, si forcohet një vozë e

madhe druri. “Mbulojeni tani me tokë dhe mbillni sa më shumë pemë”, tha dhe iku për të mos u kthyer më në ato anë.

Rrathët e hekurit njerëzit i quanin obruç, ashtu siç ua kishte thënë Mjeshtri. Askush nuk e dinte se sa vite e shekuj kishin kaluar që atëherë, por brez pas brezi kishin jetuar me frikën se cili do të ishte më qëndrestar, mallkimi i Djallit apo obruçi i Mjeshtrit. Dhe kjo frikë u shpërhap edhe më shumë ditën kur u dëgjua një shpërthim që tronditi të gjitha dyert dhe dritaret.

“O Zot, mos po na pëlçet obruçi dhe na fshin me të gjallë dhe të vdekur”, thanë njerëzit pa e ditur se nga kishte ardhur ai shpërthim.

“Tani po, - tha Ismen Kallabaku në një kuvend me burra, - të gjithë e morëm vesh se legjenda paska qenë e jona!”

Shumë fshatra, dhe madje krahina, ishin grindur qysh se nuk mbahej mend se e kujt ishte ajo legjenda e Djallit me Mjeshttrin. “Nuk mund të jetë legjendë e gjithë Gorës, është vetëm e fshatit tonë”, thoshin andej-këndeje. Sidomos fshatrat që ishin ngritur në bokza e brinja mali, të rrethuara nga dy a më shumë lumenj, kishin jetuar në shekuj me frikën e mallkimit të Djallit.

Në kohërat e hershme secili donte t’ia linte legjendën tjetrit, si kopilin te dera, por më vonë, kur njerëzit e *komitetit pa ballkon* filluan të bredhin fshat më fshat për të shkruar “historikët” e tyre, në garën për t’i bërë sa më të bukur, disa nga fshatrat thanë se



legjenda ishte e tyre. Madje grindja u përhap si zjarri në pyll, kapërceu nga Gora në fshatrat e Grykës, e nganjëherë ngucej deri në Rrafsh të Lumës. U mblodh edhe një simpozium, në të cilin mori pjesë edhe vetë kryetari i Akademisë së Shkencave. I pari e mori fjalën një mësues nga Topojani, të cilin filluan ta quanin filolog qysh se mbaroi Institutin e Shkodrës me korrespondencë. Ai u përpoq të thoshte se legjenda u takonte atyre, se ishin bajrak i parë, se Jup Topojani kishte shkuar deri në Nish, se Sinan Pasha i Topojanit kishte një legjendë të vetën, se mali i tyre kishte filluar të rrëshqiste tre vjet më parë, por, krejt papritur, gjithë atë diskutim shkencor, ia rrahiti dikush që foli nga fundi i sallës.

“Pse ia fusni kot? - i tha ai. - Legjenda ka dy lumenj, ju keni vetëm një.”

Atij të Shishtavecit i thanë se nuk kishin ndonjë mal përsipër që të shembej, se lumi i tyre ishte thuajse përrua, por kishte marrë emrin e Ilinës, që ishte mbytur në atë përrua si Ofelia e Shekspirit.

“Pse nuk mbani legjendën tuaj, është më e bukur!”

Kur dikush përmendi disa fshatra të Gorës jashtë Shqipërisë, që e kanë atë rrezik legjende, si Orçusha, Krusheva e Restelica, një i dërguar i *komitetit pa ballkon* ia mbylli gojën menjëherë me fjalët: “S’kemi punë me revizionistët”.

Sa për pretendimet nga Nimça, Lojmja e Bela, ishte më e thjeshtë, atyre u thanë se nuk është e mundur të përmbytet nga shpërthimi i obruçit, se ju keni bërë njëqind vjet luftë me djallin për t’ia zënë vendin aty

ku jeni, një vend i mallkuar, ku vetëm dreqi mund të jetojë... Më lehtë ishte me ata të qytetit, që donin të përfitonin nga fakti se ishin në mes të dy Drinave dhe nën Gjallicë. “Legjenda ka lindur treqind vjet përpara jush”, u thanë.

Më keq plasi sherri me Bukojnën, Cërnalevën, Borjen dhe fshatrat e tjera, që ishin përballë njëra-tjetrës dhe lageshin nga të njëjtët lumenj, vetëm se nuk dihej në cilin mal ishte fshehur djalli: majtas, djathtas, apo përballë.

“Edhe andej, edhe kënde, - tha Ismen Kallabaku, që ishte thirrur bashkë me pleq të fshatrave të tjera për ta treguar legjendën përpara kryetarit të Akademisë. - Që nga gryka e Vanave e deri në Bjeshkë të Brodit.”

Kur kryetari e pyeti Ismenin pse grindeni kaq shumë për një legjendë që ju shpërkeq të gjithëve, mori një përgjigje që as e priste dhe as e mbajti shënim. “Ç’kemi tjetër për t’u grindur? Vetëm bajga dhe legjenda!”

Njeriu i parë që mbërriti në vendin ku kishte ndodhur shpërthimi, ishte Mirjet Xhiritlia, dhe jo pse u gjend më afër, por ngaqë vetëm ai në atë fshat merrej dhe dinte diçka nga punët e ndërtimit, të gurëve e të zhavorrit, të rrëshqitjeve të tokës e të malit. Kishte bërë një shkollë diku në Tiranë, apo në Durrës dhe të gjithë e quanin teknik. Por, kur u rindërtua xhamia e fshatit, sidomos kubeja e saj, për të cilën shumë njerëz mendonin se do të shembej brenda natës, dikush e quajti inxhinier dhe sa më shumë muaj e vite kalonin dhe qëndronte e palëvizur, aq më tepër shtoheshin njerëzit që e zëvendësonin fjalën “teknik” me “inxhinier”.

Gjëja e parë që i ra në sy ishte një bisht dhelpre i gjakosur, mbetur i varur në një dëllinjë atypari, ndërsa trupi i saj ishte zhdukur në mijëra copa të shpërndara

kahmos nëpër Deklinë. Por ndjeu të therme përanash zemrës dhe sytë desh i dolën vendit, kur pa gropën e madhe që kishte hapur shpërthimi, që iu duk si një krater vullkani, vetëm se në përfytyrimin e tij u përshfaq një bujanë e paparë uji, që merrte përpara gjithçka, gurë e dhé, shtëpi e pemë, njerëz e bagëti, bletë dhe lule. “Do të mbytemi në lurmë e llapërcinë”, mendoi.

“Të gjallë dhe të vdekur”, iu kujtua fjala që thoshin njerëzit që kur lindnin e derisa vdisnin. “Nuk e thonë kot, - tha dhe po mendohej ai duke parë pak më tutje varrezat e fshatit. - Po të shpërthejë uji i dy lumenjve, do të shkojmë në atë botë bashkë me të vdekurit tanë. Të shkretët këta, mund të vdesin për së dyti, - mendoi, por iu duk sikur dëgjoji edhe zërin e vet. - A thua fola me vete? - u çudit ai. - Ç’do të ketë qenë vallë ajo lubi që e ka hapur këtë krater, - pyeti veten, - shpërthim i tokës, apo meteor i qiellit?”

Dhe krejt mendjehuptas në përgjigjen që duhet të jepte, arsyetoi trishtueshëm se gjeneralët prandaj i emërtojnë me dy yje, me tri yje, me katër yje, sepse hapin gropa sa yjet e qiellit.

Kur u fut në gropë, në një cep të saj preku lagështirë, rrëmoi me thonj e me duar dhe vuri re që ajo vinte për së brendshmi.

“Mali paska vërtet ujë”, mendoi. Kushedi sa herë e kishte dëgjuar legjendën e Djallit dhe të Mjeshtrit, por në të shumtën e rasteve nuk e besonte, megjithëse kohë pas kohe mendonte, madje edhe kishte lexuar nëpër libra, që çdo legjendë në fillesën e saj ka pasur

diçka nga jeta e përditshme e atyre njerëzve, që më vonë e kanë mitizuar. Askush nuk mund ta besonte se qe e vërtetë legjenda e nënës që dogji të gjithë pyllin, në të cilin kafshët e egra ia shqyen djalin e vetëm dhe mbi tokën e përvëluar mbiu vetëm bar, dhe u krijua bjeshka e Kallabakut, por kur në vitet e kooperativës e përmbysën një pjesë të bjeshkës për ta mbjellë me patate, traktoristët zbulonin ngado tokë të zezë, madje edhe thëngjij të shuar.

Dëgjoi zëra dhe u përpoq ta mbulonte me të thatë dheun e njomur të gropës, që të mos e shihnin ata që po vinin. Kur u nis të dalë, vuri re se nuk kishte asnjë cep guri apo rrënjë dëllinje, ku të mund të kapej për të dalë jashtë. Pas pak pa sipër vetes disa koka të fshatarëve dhe ashtu, të rrahur nga mbrapa prej rrezeve të diellit, iu dukën sikur sapo kishin zbritur nga qielli.

“Paske mbetur brenda, inxhinier”, i tha dikush.

“Të gjithë brenda jemi”, tha ai i menduar, ndërsa po kapte një cung dëllinje, që po ia zgjasnin për ta nxjerrë nga gropa e stërmadhe.

“Si të duket?”, e pyetën kur doli.

“Shih e mos shkruaj”, u përgjigj dikush në vend të tij.

“Si të mos shkruaj, o budalla? - thirri një tjetër. - Të shkruajmë, e të shkruajmë shumë, madje! Qeverisë, Amerikës, Klintonit, të gjithëve! O bablok, një ortek ra në Shtiçën dhe qeveria i hoqi e u dha pará për të ndërtuar shtëpi në Tiranë. Po, po, në Bathore, por Tiranë është edhe atje.”

“Unë nuk e braktis tokën e të parëve”, foli tjetri.

“Rrini, pra, këtu me të parët tuaj, - u tregoi me dorë varrezat, - dhe pritni që t’ju fshijë obruçi me laçkë e me plaçkë. Unë për vete qysh nesër do t’i ngarkoj çaklat dhe do të iki me teshë e me koteshë.”

Mirjet Xhiritlia u nis pa folur.

Të tjerët i shkuan nga pas.

Askush nuk mund ta thoshte me siguri se nga erdhi ai shpërthim. Të shumtët mendonin se ndonjë nga pilotët bombardues të NATO-s, i lodhur nga rruga e largët dhe në përgjumje e sipër, ka prekur ndonjë sumbull të gabuar. Të tjerët, përkundrazi, flisnin me siguri se bomba kishte ardhur prej matanë kufirit për inat të fshatit, meqë avionët bombardues kalonin atypari. Madje, ky grupi i dytë deklaronte me të madhe se kjo ishte bërë me qëllim që fshati të armiqësohej me pilotët bombardues.

“Nuk ndodh asgjë rastësisht e pa qëllim, - bërtiste njëri prej tyre, - a dëgjuat që në Bardhoc ra një raketë mbi bunker dhe e ktheu gjithë atë bina me bythë përpjetë? Kujtoni se ishte gabim, aaa, posi, posi! E hodhën bunkerin bythëpërpjetë që t’ju tregojnë juve,

enveristëve, se kështu do t'i bënin gjithë bunkerët po t'i hapnit luftë Amerikës.”

“E ç’ju duhej bunkerit, kur e hodhën me bythëpërpjetë gjithçka që pati lënë Enveri”, po thoshte dikush. Ndërsa një tjetër, që sapo hyri, bërtiti: “Ishte meteor”.

Ky varianti i fundit i dha fshatit të tyre përmasat e luftës së yjeve. Pas dy ditësh doli edhe një vramendje e katërt, që thoshte se shpërthimin e ka bërë zhavorrshitësi i madh, Çopur Çabraku. “E mbaroi gjithë zhavorrin e varrezave, tani kërkon në mal që të hapë varre të reja”, thanë mbrojtësit e kësaj pandehme të re.

Por, ndërsa bënin gallatë nëpër klubet e fshatit, kur hynin në shtëpi, burrat strukeshin brenda frikës së tyre, aq më tepër e vrundullonte atë frikë vështrimi naiv dhe pyetës i grave: “Ç’do të ndodhë me ne?”. Kjo frikë ishte gjumëvrasëse, në fillim nëpër familjet që banonin në shtëpitë anës Përroit të Shurdhër, poshtë kraterit, dhe më pas u përhap në gjithë fshatin.

“Po shpërtheu, na mori të gjithëve, janë dy lumenj të mbledhur në barkun e malit qindra e qindra vjet me radhë, dhe, mos harro, kanë inatin e djallit brenda.”

“Fajin e kanë ata që zgjuan djallin e fjetur, - shtoi dikush, pa e cokatur atë që kishte në mendje.”

“Po në qoftë se ishte meteor, me cilin djall do të kapesh ti?”

Të gjitha këto Mirjet Xhiritlia i përjetonte dhe i dëgjonte, por kur u ul të shkruajë një raport për çka



ndodhi mbi fshatin e tyre, nuk përmendi asgjë prej sa dëgjonte poshtë e përpjetë.

Ai e nisi të shkruarën që në fillesë me legjendën dhe mallkimin e Djallit, me obruçin e Mjeshtrit dhe me kraterin e rrezikshëm nga mund të shpërthenin të dy lumenjtë bashkë, i bardhi dhe i ziu, e ta bënin fshatin perishan. Bëri edhe një histori të shkurtër të të gjitha rasteve kur fshati ishte gjendur i kërcënuar dhe i trembur nga këputja e mundshme e obruçit, që nga koha e llagëmeve, që hapi ushtria e Nemces në Luftën e Parë Botërore, nga koha e urisë së dytë, kur barkpanginjurit prisnin pyllin mbi fshat për të bërë e për të shitur qymyr, e deri në mbërritjen e ndërmarrjes pyjore, që i bëri rrafsh ahet shekullore e në vend të tyre mbolli plepa për fabrikën e letrës. Por rreziku më i madh për mendimin e tij ishte ai që u shfaq në vitet e fundit, kur një biznesmen solli fadroma e buldozerë për të nxjerrë zhavorrin e malit e për ta shitur për hesap të vetë, atë që natyra e kishte falur për të gjithë. Mirjeti nuk harroi të përmendë edhe faktin se gërmimet për zhavorrishtë kishin shkuar aq thellë e gjerë, saqë në skaj të varrezave kishin filluar të zhdukeshin majëkresat dhe të dilnin skelete të vdekurish pa emër. “Po i shtroni rrugët e qyteteve tuaja me vdekjen”, shkroi në fund të atij sythi, por pastaj u pendua dhe e hoqi. “Më mirë po përqendrohemi te vdekja, që na ka trokitur në derë; dhe ç’ të trokitur! Përplasën kokat qielli me tokën.” Edhe kjo shprehja e fundit i pëlqeu, por përsëri hoqi dorë. “Letrarizmat nuk të japin bukë as në shtëpi dhe as në qeveri! - mendoj duke

pasur parasysh se atë raport do t'ia dërgonte edhe qeverisë, edhe prefekturës, disa ambasadave dhe së fundi mendoi edhe për Akademinë e Shkencave. - A kemi ende Akademi? - pyeti veten duke kujtuar se çfarë kishte lexuar aty-këtu dhe, duke mbyllur zarfet, mendoi idhshëm se në ç'duar do të binin ato, a do t'i hapte ndokush dhe a do ta vinin ujin në zjarr. - Askush!”, u shpirtkeq ndërvete, duke kujtuar dhjetëra letra kundër zhavorrbiznesit të varrezave, që kurrë nuk morën përgjigje.

Shtatë ditë pas shpërthimit, sikur të pikte prej qiellit, në fshat erdhi një njeri, të cilin shumica e dinin të vdekur, disa e kujtonin të humbur pa nam e nishan dhe një pjesë fare e vogël mendonin se ai ishte ende gjallë, diku në dhera të tjera. Edhe vetë Petrit Kallabaku, sikur t'i dinte gjithë këto hamendje të njerëzve për të, të parit që takoi dhe kur ky e pyeti gjallë qenke, iu përgjigj, më mirë të mos isha!

Tjetri i tregoi se lajmi për vdekjen e tij ishte përhapur dy-tre vjet të shkuar, madje me ndërhyrjen e një deputeti, arkivolin e sollën s'dihet se nga, ku kishte shkuar bashkë me ikanakët e tjerë të krahinës. E vajtuan gratë me gjëmë dhe burrat nën heshtjen e tymit të duhanit. Kur po e nxirrnin arkivolin për ta përcjellë për në varreza, motra e tij, e vetmja motër që kishte, u hodh mbi arkëmortin dhe vajtueshëm e

me ulërima, që trembën edhe yllzit, thërriste: “Dua ta shoh edhe një herë vëllanë, hapeni arkivolin”.

“E di, e di, e kam dëgjuar”, tha tjetri, thujse pazëshëm.

“Plasi nga mërzia babai yt”, i tha fshatari para se të ndahej me të.

“Mërzisë tënde iu shtua edhe kjo tjetra, u nis motra të të gjente, por humbi edhe ajo...”

Petrit Kallabaku e pa tjetrin si kau në pus dhe nuk foli.

E dinte që motra kishte trokitur në derën e tij dhe nuk mund të dilte duarthatë. Pa kaluar as tre muaj i vdiq babai dhe në shtëpi mbeti vetëm vajza që kishte hapur arkëmortin. Mbeti qyqe vetëm. Nëna i pati vdekur shumë vite më parë nga një leucemi e rëndë dhe babai nuk u martua më; iu përkushtua rritjes së dy binjakëve, Petritit dhe Jetmirës. Vetëm një javë pas vdekjes së babait, ajo i vuri drynin e zi shtëpisë dhe u nis në kërkim të vëllait. Rrotullnajë nëpër botë. Në fillim shkoi në Greqi, duke kapërcyer Gramozin në këmbë. Takoi disa djem nga fshati i tyre, ata u përpoqën ta ndihmonin, por nuk e gjeti dot vëllanë as në Rodos dhe as në Kretë. Ishin të gjithë gjurmëhumbur, sepse shumica kishin ndërruar emrat dhe dikush quhej Spiro, dikush Mihal e ndonjërit madje i kishte qëlluar edhe emri i kryeministrit të atëhershëm të Greqisë, Kostas Simitis. Nga Greqia u hodh në Itali, me një traget të Igumenicës dhe që nga ajo ditë e për tre vjet me radhë nuk u dëgjua më asnjë fjalë për të. Xhaxhai i saj, Ismen Kallabaku, përvëlohej tejtejet në gjoks e

shpatull kur dëgjonte fjalë për të, por gjithnjë përpiquej t'i përzinte nga lamshet e trurit ato zhigma që i sillte veshi. Asnjë shenjë ndjellamirë.

“Më mirë të mos e kishte hapur atë arkëmort, - u thoshte njerëzve, kur binte fjala për të. - Kur ke plagë në zemër, jeta të shikon shtrembër.”

Kur arriti afër shtëpisë, pa diçka që nuk e priste, sëraku i rrobave, i nderur në një cep të oborrit, ishte plot me rroba që ishin vënë për t'u tharë. Kjo gjë e habiti aq shumë, saqë nuk e vuri re se ato ishin të tëra veshje grash, ashtu si nuk vuri re sa shumë ishte rritur dardha në degët e së cilës lidhej njëra anë e sërakut. “Mos kam ngatërruar shtëpinë?”, i shkoi nëpër mend, por në atë grimëherë doli te dera një vajzë a grua, të cilën jo vetëm që nuk e njihte, por edhe nga mënyra e të veshurit dhe nga qëndrimi paksa i ndërdyshur, kuptohej menjëherë se ishte e ardhur, por si, pse dhe nga, ai as që mund ta merrte me mend.

“Kërkon njeri?”, e pyeti.

“Kërkoj veten”, i tha ai. Vajza e mori për tallje këtë përgjigje dhe u nis të futej brenda, por një “qëndro aty”, e thënë me zë të panatyrshëm, e ngriu në vend.

“Kush je ti”, e pyeti.

“Jam djali i shtëpisë”, tha duke mos ditur ç'përgjigje tjetër të jepte.

“A, Petriti?”

“Nuk i ka mbetur kush tjetër kësaj shtëpie”, tha ai hidhur.

Kur u fut brenda, gjeti edhe një tjetër, paksa më të re, por me një vështtrim që kolovitej midis frikës dhe trishtimit.

“Unë jam e Kosovës, kurse Hana është e fshatit tuaj. Kemi mbetur qyqe dhe këtë shtëpinë tuaj e morëm për çerdhe.” Ai nuk foli, por kthente kryet në të katra anët e shtëpisë dhe vetja i dukej edhe më zbrazët se cepat e saj.

“Ka plot shtëpi të tjera të braktisura, do të gjejmë ndonjë tjetër dhe ti rehatohu në shtëpinë tënde, - i tha. - Po të bëj një kafë të të heq rrugëlodhjen.” Ai tundi kokën dhe nuk foli. Kur mbaroi kafenë, u ngrit, shkoi nëpër dhomat e tjera dhe kur u kthye, mori trastat e rrobave dhe doli.

“Rri, rri këtu, unë po kaloj nga mixha, pastaj shohim e bëjmë.”

Shtëpia e xhaxhait nuk ishte shumë larg prej aty dhe dukej edhe ajo si e braktisur, ose ndoshta atij iu duk ashtu, kur kujtoi çfarë kishte dëgjuar dhe lexuar, madje edhe në një gazetë të vendit ku punonte. Ndryshe nga ata që ishin vetëm vëlla e motër binjakë, pa të tjerë, xhaxhai kishte shtatë fëmijë, katër djem e tri vajza, të gjithë ikanakë nëpër botë. Ashtu të përhapur, ca në Amerikë dhe ca në Europë, ose e kishin harruar fare babën, ose për mungesë vizash dhe parash, asnjëri nuk erdhi ta shikonte qoftë edhe një herë. Dikur i dërgonin edhe ndonjë dollar apo marka, por edhe ato i prenë kur u bënë me fëmijë, apo kur ngeleshin pa punë. Në krye të shtatë vjetëve, Ismen Kallabaku dërgoi atë drejt telegrami, që çuditi njerëzinë dhe e morën gazetat e Shqipërisë e jashtë saj: “Babai juaj vdiq. Varrimi do

të bëhet kur të mblidheni të gjithë në shtëpi. Të rroni vetë. Kryeplaku i fshatit”.

Centralistja e komunës nuk pranoi ta dërgonte atë telegram, ti je gjallë, i thoshte, dhe ai u detyrua të zbriste në qytet për ta nisur. Kur djemtë dhe vajzat erdhën ta varrosnin, ai i priti në oborr, me një gotë rakië në dorë e me pika loti në sy. Ata u zemëruan, njëri deshi edhe ta godiste në nerva e sipër, por ai buzëqeshi dhe u tha:

“Tani edhe të vdes, vdes i ngopur nga sytë, ju pashë e u çmalla, se kushedi a shihemi më në këtë botë. Të gjithë jeni bërë si zogjtë pa krahë, shkoni dhe nuk vini...”.

Kur hyri Petriti, ai e përqafoi me xhongël dhe i tha:

“Eja, nipash, eja. Më në fund edhe ti e more vesh që kam vdekur dhe erdhe të më varrosësh. Mirë bërë, mirë. Por për babanë nuk erdhe ama, nuk t’u bë mbarë”. Ai nuk foli fare, dukej sikur e kishte kapur ngrija. Pastaj mori frymë thellë, sikur të ishte mbaruar ajri i tërë botës.

Ismen Kallabaku, duke pirë një hulm raki, i ra disa herë rrotull bisedës me nipin për të marrë vesh rragimet e tij për nëntë vjet në emigracion, i foli për arkëmortin që u erdhi dhe gjëmën që dëgjoji ajo shtëpi duke menduar se ai kishte vdekur, për mpirjen e të gjithëve kur u zbulua nga motra dhe doli një tjetër Petrit Kallabak, që kishte vdekur në ato dhera të huaja.

“Po, me Jetmirën, a u gjetët?”, pyeti Ismeni.

Petrit Kallabakut i erdhi shtëpia vërdallë, por nuk foli.



“U nis të të kërkojë ty, por nuk u kthye më. As djemtë e mi nuk e kanë takuar... U bënë vite.”

“As unë, - deshi të thoshte Petriti, por fjala i mbeti në fyt. Për t’i bishtnuar përgjigjes, pyeti: - Si të shkoi mendja tek ai drejt telegrami?”

Ismen Kallabaku pështyu cigaren, që i ishte ngjitur në cep të buzës, e shuar qysh se kishte hyrë Petriti në shtëpi.

“Eh, si më shkoi? Njeriu pa fëmijët jeton midis thumbit dhe patkoit, buza i qesh, por syri i qan, vetëm zemra bën durim dhe mban. U ngrita një mëngjes rrëmujtas nga një ëndërr e gjëmshme. I thashë vetes, ç’bën o Ismen Kallabaku? Ke parë të qëllohen dy perandorë, një në Sarajevë e tjetri në Tiranë, ndërsa tani nuk shikon dot as fëmijët, që u ke dhënë dritën e syrit? Shkova në postë dhe e çaprashita atë telegram... Njeriun e mban gjallë era e bukës, shija e kripës dhe hatri i fëmijëve.”

Punën e dy perandorëve Petriti e kishte dëgjuar disa herë, madje shpesh fëmijët e Kallabakëve gërdufeshin me moshatarët e tyre duke i treguar ato histori të çuditshme. Dhe për ta larguar sa më shumë pyetjen për motrën, ai e nxiti xhaxhanë t’ia tregonte edhe një herë. Ismenit i erdhi mirë, qenë bërë vite që askush nuk e pyeste më për ato dy ngjarje të paharruara... U fut në rrjedhën e asokohëshme.

“Njëqind vjet para jush edhe unë kam rrahur kurbetin ose emigracionin, siç i thoni ju tani. Ju shkuat të rritur, kurse unë isha vetëm nëntë apo dhjetë vjeç. Shkova në Sarajevë, se atje vinin shumë emigrantë

nga Gora jonë. Edhe pse macúk, isha më i madhi i shtëpisë e duhet të sillja ndonjë grosh për bukë. A e din për sa ditë e kam bërë rrugën deri në Sarajevë? Nëntë ditë. Ditën e parë deri në Prizren, të dytën deri në Ferizaj, në të tretën pashë tren për herë të parë duke shkuar për në Mitrovicë, prej aty në Novi-Pazar, më tej deri në Tashkaligje, siç e quanin turqit atëherë Plevjen. Ditën e shtatë a të tetë arritëm në Proboj, ku ndahej kufiri mes dy perandorive, Turqisë dhe Austro-Hungarisë. Aty ngelëm dhe, për të ngrënë një copë bukë, shitëm kalin. Unë kisha mbetur këmbëcullak. Dy javë na mbajtën austriakët në kufi, por më në fund na lejuan. Para se të kalonim kufirin, na futën në banjë, na lanë e na dhanë rroba të reja e na nisën për në Sarajevë...”

“Jua lanë morrat e Gorës”, ndërhyri Petriti.

“Më mirë të të lajnë morrat, sesa të t’i shpëllajnë trutë”, foli thatë Ismeni.

Petritit i dogjën ato fjalë dhe nuk e ndërpreu më derisa e tregoi të gjithë ngjarjen me atentatin e Princ Ferdinandit. Rrugët e Sarajevës ishin plot me kureshtarë që donin të shikonin princin, që po vizitonte qytetin. Ismeni, si gjithë shegertët, kishte zënë një cep të urës mbi lumin Miljaçka, aty ku do të kalonte princi. Dëgjoi krismat dhe nuk e pa princin që u plandos në tokë, por pa dikë që u hodh nga ura në lumë dhe pastaj dhjetëra të tjerë që u hodhën pas tij dhe e prangosën. Ai ishte atentatori që solli Luftën e Parë Botërore.

“Ato të dyja, që kanë zënë shtëpinë tonë, ç’janë e nga janë?”

Xhaxhai i tregoi se njëra nga vajzat ishte e bija e Jallman Xhimshitit, një fshatar i tyre, që dikur jetonte me tri vajzat e veta dhe me motrën e tij, lëneshë të plakur. Gruaja i kishte vdekur dhe të gjithë bënëin çudi pse nuk u martua përsëri, por, kur e pyesnin, ai përgjigjej shkurt: “Jam martuar me rakinë”. Dhe vërtet, ishte një pijanec e kopickuq me nam, aq sa shiti disa nga arat e veta vetëm e vetëm që të mos i mungonte rakia. Kishte nga ata që thoshin se edhe dy vajzat e mëdha i martoi atje ku pikonte rakia. Por e treta, thonë, nuk pranoi dhe një ditë prej ditësh, kur të gjithë prisnin që ajo të ikte nga shtëpia, vetë Jallmani u zhduk kryehuptas. “Kushedi ç’gropë e molishtë ka zënë, ashtu si dehej ai.” Pas zhdukjes së tij vajza nuk qëndroi më me hallën, por u bashkua me kosovaren dhe filluan të jetonin bashkë, si dy motra.

“Po kosovarja nga ka ardhur?”, pyeti Petriti.

“Nga një milion që erdhën në gjithë Shqipërinë, dyzet ishin vetëm në fshatin tonë. Sa u çlirua Kosova, të gjithë u kthyen në shtëpitë e tyre, vetëm ajo mbeti këtu. Nuk kam njeri atje, m’i kanë vrarë të gjithë, thoshte. Kushedi ç’hall i madh e ka zënë të shkretën; çdo bjeshkë e ka terrin e vet.”

Petrit Kallabaku nuk e trazoi më prushin e kureshtjes, sikur të kishte frikë se mos e digjte.

Kishin kaluar disa javë që nga dita e shpërthimit mbi fshat dhe Mirjet Xhiritlisë nuk i kishte ardhur asnjë përgjigje për letrat që kishte dërguar. Çdo ditë shkonte te gaverna e madhe dhe kur shikonte shenjat ndjellakeqe, që e alarmonin, dhe e trembnin, vraponte në postë, ku i jepnin të njëjtën përgjigje: nuk ka gjë.

Në vend të përgjigjeve erdhi në fshat biznesmeni i zhavorrit të varrezave, Çopur Çabraku. Ai nuk u ndal asgjëkund, por shkoi drejt e në shtëpinë e Mirjetit.

“Ka shkuar të shohë a mos po këputet obruçi”, i tha e ëma duke mos e njohur e duke kujtuar se ishte ndonjëri nga ata, që i biri priste t’i kthenin përgjigje për letrat që u kishte shkruar.

Ai u kthye dhe hyri në klubin më të madh të fshatit dhe urdhëroi klubistin që askujt të mos t’i merrte lekë

atë ditë, çfarëdo që të pihej. Hodhi një grusht me pará dhe u largua.

“Sa lirë na e shet vdekjen ky ciribash syçapin!”, tha njëri nga fshatarët, që nuk pranoi të pinte asgjë.

Thuajse askush nuk kujtohej më se Çopur Çabraku nuk ishte djalë i fshatit të tyre. Shumë vite më parë, gjyshen e tij, vajzë 17 vjeçe, e grabiti një tufë hajdutësh nga Gryka dhe në udhëkryq e hodhi në short me fije kashte se kush do ta merrte për grua. I ra një caradungu, që e mori për grua të dytë. U bë nënë e gjyshe në atë fshat të panjohur. Kur nipi i saj, Çopuri, u bë belaxhi i madh, ajo e solli në fshatin e vet të lindjes, te dajallarët. “Daja shtin pushkë për nipin dhe e var pushkën në kunj të vet, por, kur shtin nipi, e var pushkën në kunj të dajës”, u tha dhe iku. Dhe Çopuri nuk u kthye më në “shkrepat e Grykës”, si thoshte vetë.

“Atje ka vetëm kumbulla gomari, kurse në bahçet e dajallarëve rriten edhe dardha, edhe mollë, kumbulla të verdha e kumbulla të zeza, kajsi e zerdeli, bletë dhe pula.”

Sidomos me pulat u dalldis dhe erdhi një ditë, kotecet dridheshin nga hapat dhe era e rëndë e Çopur Çabrakut. Bashkë me një shokun e tij, Ramush Dërbusin, nuk linin furrik pa grabitur, aq sa fshatarët u detyruan të lidhnin qentë pranë koteceve për të ruajtur pulat. “Një stërhell, një caradung, s’lanë një pulë në katund”, thoshin fshatarët, sepse Ramushi ishte i gjatë, ndërsa Çopuri i shkurtër, caradung si gjyshi i vet. E lanë këtë marifet vetëm vitet e fundit

të kooperativës, kur u bënë ato të nëmurat tufëza dhe arëza, dhe fshatarët vrisnin edhe më të mirin e fisit për një pulë apo një kec. Ikën të dy në Tiranë dhe gati u harruan, por një ditë erdhi lajmi se ata ishin arratisur. Edhe më shumë u çuditën njerëzia kur morën vesh se kishin mbërritur në Amerikë. Por disa javë më vonë erdhi një lajm ndryshe nga i pari: në Amerikë, thoshte lajmësi i dytë, kishte shkuar vetëm Ramushi, ndërsa Çopur Çabrakun e kishin rrasur brenda. U përhapën fjalë për dhjetëra arsye të burgosjes së tij, por e vërteta nuk u kthjellua asnjëherë, sepse as ai dhe as ata që i vunë prangat nuk deshën ta tregojnë. U dënua tetë vjet dhe bëri vetëm dy, gjë që nxiti një thashethemnajë të re.

Kur në Shqipëri nisën rrjedhat demokratike, Çopuri brodhi nëpër fshatra, foli edhe nëpër ca radio e gazeta dhe më shumë nëpër klube, ku, ndryshe nga Skënderbeu, thoshte “lirinë ua solla unë”. Kur e pyesnin për shokun e tij të pulave, thoshte se u tregua budalla, Amerika paska qenë këtu dhe ne nuk e kemi ditur. Dhe Amerikën e parë ai e gjeti në zhavorrishten midis fshatit dhe varrezave të tij, nëpër bërlinat rrëzë bokzave të malit.

Por më shumë sesa për Amerikën, ai tregonte dhe mburrej me atë që të gjithë e quanin “Nata e Grykës”. U vranë gjashtë veta në atë kobnatë.

“Fis i ngatërruar, - thoshte Ismen Kallabaku, - që në kohën e luftës u ndanë në dy pjesë, Ibishi me partizanët, Mersini me bajraktarin e Lumës dhe milicët e Dibrës...”

Kur u vra Ibishi në rrethimin që i bënë në një lamth përskej fshatit ishte aty edhe Mersini. Në grahmat e fundit, bashkë me gjakun që i gufonte nga goja, partizani i plagosur nxirrte vetëm një fjalë... ujë... ujë... ujë... e kishin përvëluar plumbat dhe donte të ikte nga kjo botë duke i marrë asaj vetëm një pikë ujë.

“Jepini ujë mutit...”, thirri bajraktari. Mersini u afrua me pagur mbi kryet e të vrarit. Kur pikat e ujit i ranë mbi fytyrë, ai çeli sytë dhe sapo njohu kushëririn e vet, ktheu kokën mënjanë e nuk e piu ujin e tij. Vdiq me rreshkën përvëluese ndër buzë. Kur partizanët ia morën krahët bajraktarit dhe ai u çartallos nëpër male, edhe Mersini i shkoi pas, por në përpkjet për të kaluar kufirin, ai dhe disa të tjerë u vranë për t’i çelur rrugën e arratisjes bajraktarit të tyre.

Partizanët e sollën te Kroni i madh, e tërhoqën zhag dhe e hodhën që ta shihnin gratë kur të mbushnin ujë. Kur e pa nëna e tij, i vikati të vdekurit: “O Mersin, të paskan bërë mish! Pse u dorëzove dhe nuk i rrahite krejt komunistët?”. Partizani i tha: “Gjuhën gjarpër e paske, por do të ta presim, do ta thajmë që në rrënjë farën tuaj të keqë”.

Shumë vite më vonë, kur në atë fis lindi një djalë, e quajtën Mersin për ta ringjallur emrin e atij që u vra në krah të bajraktarit.

“Qitën pushkë në zjarr të vet, - tha Ismen Kallabaku kur dëgjoi për këtë përzgjedhje emri nga plaka ngrehuajkë, të cilën shumëkush në fshat e quante shtriga Zire. - Më shumë se gjysmëshekulli ka

kaluar dhe lufta u mbeti në mes të vatrës”, tha Ismeni për zezomën e atij fisi.

Vëllai i Mersinit të parë, Destani, u arratis në Jugosllavi, pas disa vitesh doli përsëri këndeje për të marrë familjen, por e kapën në një pyll të vogël, të cilin kufiri e ndante mes dy shteteve... E dënuam me 18 vjet burg, por kur doli kurdisi atë nam që s’kishte ndodhur më parë. Ngjarja ndodhi pa mbushur vitin që nga dalja e tij prej burgut. Nëna e tij, Vezirja, i tha ta martonte se kishte mbushur dyzet vjet, por ai të tjera dasma bluante në kokë. Vëllai i tij, Rexhepi, ishte pesëmbëdhjetë vjet më i vogël, punonte në uzinën e bakrit dhe në pamje të parë dukej djalë i mirë, pa sherr. Motra e tyre ishte 20 vjeçe. Megjithëse e kishte vëllanë në burg, u dërgua në shkollë duke treguar biografinë e kushëririt dëshmor dhe u bë ekonomiste, punonte në kooperativë, i kishin vënë nofkën “Çanta”, meqë shkonte gjithnjë andej-këndeje duke tundur një çantë bezhë me rripa jeshilë, që nuk e hiqte kurrë nga dora. “Edhe natën e vë për nënkresë”, talleshin disa me të.

Një natë me shi e furtunë, Destani, vetë i pestë, doli nëpër terr e meçavë të kërkonte armë. I pati thënë nipit të vet, Adilit, që t’i vidhte ndonjë kallash në repartin ushtarak, por ai ose nuk mundi, ose nuk deshi dhe nuk solli gjë kur erdhi me leje. Destani rrëmbeu sëpatën dhe doli bashkë me natën e zezë. Të parin vrau rojën te stalla e lopëve, ngjitur me depon e armëve. I la shtatë jetimë pa baba. Pastaj vrau edhe një tjetër, rojën e armëve, një ish-partizan me këmbë të prerë në



Operacionin e Dimrit; edhe atij i la 6 jetimë. Të dyve ua preu kokat me sëpatë. “Ish-partizani ka qëndrue boll”, thonë, por pushka i ka qëlluar nën mushama dhe s’ka mundur ta nxjerrë para se t’ia prisnin kokën.

Kur u nisën për të ikur, Adili nuk vazhdoi me ta, shkoi në repartin më të afërt ushtarak dhe lajmëroi për zezomën që po ndodhte. Ushtri dhe polici iu vunë nga mbrapa. Ata kaluan Majën e vogël, u futën nëpër Grykë për të dalë në bjeshkët e Gorës, ku do të kalonin kufirin. Ndaluan diku në një mulli për t’u ngrohur e për t’u tharë pak. Rexhepi shkoi të kërkojë shkrepëse dhe trokiti në shtëpinë e Çabrakëve.

“A ke një shkrepëse?”

“Kush je ti?”

“Jam zborist.”

“Shkrepëse nuk kam, por po të jap prush.”

Në dritë të prushit e kanë dalluar ndjekësit dhe e kapën. Pastaj i rrethuan të tjerët në mulli. Kanë qëndruar derisa janë vrarë të tre dhe i hoqën zhag e i plasën te “Kroni i Madh”, po në atë vend, ku gjysmëshekulli më parë patën hedhur Mersinin e parë. Rexhepin e varën te dardha e vjetër mbi krua.

Në ato kohë, babai i Çopur Çabrakut rrihte gjoksin dhe trimërohej duke thënë se prej prushit të tij u kapën kriminelët. Ndërsa më vonë i biri i tij doli nëpër presidiume dhe tubime, duke thënë që familja e tij guximtare ka ndihmuar e u ka dhënë zjarr luftëtarëve kundër komunizmit. Dhe gjithnjë shtonte edhe frazën “Atë që ua kemi bërë etërve, do t’ua bëjmë edhe bijve të tyre!”.

“Të kërkova në shtatë saraje dhe të gjeta në furrik”, i tha Mirjetit, kur ai po kthehej nga Deklina më i alarmuar se kurrë.

“Ç’të bësh, çdo qen kërkon nazdrakun e vet”, i tha Mirjeti duke i dhënë fytyrës një shprehje dykuptimëshe.

“Dëgjo këtu, kam ardhur të merremi vesh e jo të flasim me kaçkarika.”

Që kur ishin të rinj, përpara se Çopuri të futej në burg, ata ishin parë me hënë jashtë me njëri-tjetrin. Disa herë Mirjeti e kishte kapur duke vjedhur pula dhe ia merrte nga duart e i lëshonte të gjenin furrikun e tyre. Por sherrit të tyre i dha prush të madh Jetmira Kallabaku. Kur e mori vesh Çopuri që ajo i kishte dërguar një tufë me karafila Mirjetit, shenjë që ajo e pranonte dashurinë e shfaqur prej tij, filloi të thoshte

për të, kalldrëmeve të fshatit, të lara e të palara. Një ditë madje i tha Mirjetit që t'i mbante karafilat, por trëndafilin e Jetmirës do ta këpuste ai i pari.

“Ke për të parë po nuk e skotoshova si kanxhi pulën në rrzëzë gardhi.”

Për herë të parë e të fundit në jetën e vet, Mirjet Xhiritlia qëllloi një njeri me grusht. Çopuri u hodh si çartan. Hynë e i ndanë, se përndryshe nuk i dihej deri ku do të shkonte ajo kimkë.

“Edhe atëherë kot u grindëm, - e filloi bisedën Çopuri. - Iku Jetmira pas të vëllait dhe as ti, as unë nuk e gëzua. Kam ardhur të ulemi bashkë të bisedojmë dhe t'u japim karar punëve tona.”

“Kush ka mort në shtëpinë e vet, nuk ndan kanun”, i tha Mirjeti.

“Mos më ngatërro mua me jagrajugrat e tua, bjeri shkurt dhe mos e kargó shumë konopin se këputet.”

“E marr me mend hallin tënd, - ia ktheu Mirjeti, - kështu ka ndodhur gjithmonë, sa herë që unë shkruaj ndonjë letër për të mbrojtur fshatin nga zhavorret e tua, ato të vijnë më përpara ty se qeverisë. Por kësaj radhe edhe po nuk të ndaloi qeveria, do të të ndalojë fshati, ose përndryshe do të shuhet përgjithmonë. Zhavorret e tua po kthehen në vorre.”

“Me ato zhavorre unë po ndërtoj Tiranën”, iu gërmush tjetri.

“Por, po na shkatërron ne të tjerëve. Shkule të vdekurit nga varret për të marrë sa më shumë zhavorr, tani kërkon të shkulësh edhe të gjallët”, i tha.

“Ç’ faj kam unë që ndodhi ai shpërthim i mallkuar!”  
Mirjet Xhiritlia qeshi hidhur.

“E di ç’ thonë disa? Se ai shoku yt, Ramushi, qenka bërë pilot atje në Amerikë dhe e lëshoi raketën nga inati, meqë nuk e lanë të vidhte më pula.”

“Përralla budallenjsh, - tha Çopuri. - Kushedi ku lan pjatat ai. Amerika është këtu për ata që duan të punojnë.”

“Ti e gjete Amerikën, po varrezave të fshatit tonë ua bërë Vietnamin, dhe tani don të shkosh edhe më tutje. E di ti se me atë shpërthim që ndodhi dhe sidomos me fadromat e tua mund të pëlçasë e të këputet obruçi, e të na zhdukë njëherë e përgjithmonë?”

“Ohuuuu! Ti jetuake akoma me legjenda! Iku ajo kohë, ka ardhur kjo, - dhe fërkoj disa herë gishtin e madh me treguesin. - Tani do të ndërtohet edhe rruga për në Kosovë dhe zhavorri do të peshohet me flori. Do të ndërtoj një fabrikë zhavorri këtu dhe dua të jesh ti në krye të punëve. E pranoj, je i zoti për punë!”

“Aq sa ti për dallavere.”

“Mirë, mendohu edhe një herë në qoftë se do t’i thuash sikter fukarallëkut. Unë mund ta bëj edhe pa ty, kurse ti s’ mund të bësh asgjë pa mua. Si i thonë asaj fjalës, mishi në vorbë, vorba në torbë.”

Mori xhaketen, e hodhi krahëve si për t’i thënë Mirjetit se unë nuk pjerdh për askënd dhe iku teposhtë rrugës së kalldrëmit. Fjalët e fundit iu ngulën si gozhdë dhe Mirjeti mbeti ndërdyshas: të shkonte pas atij brythi tinëzar, apo të kthehej në të kundërt. E

dinte se këta lloj njerëzish bëjnë të pamundurën që t'u ecë kungulli mbi ujë.

“Nuk i bëhet nder gjarprit”, mendoi

As ai nuk u çudit kur, po atë ditë, në faljen e mbrëmjes, hoxha kishte folur për të mirat që po i vinin fshatit nga djemtë e tij të suksesshëm, duke cituar diçka edhe nga Kurani. “Ja për shembull, - tha hoxha, - Çopuri do të ngrejë minaren tonë.” Ishte po ai njeri që, kur mbylleshin xhamitë dhe kishat vite më parë, lexonte citate pas citatesh dhe, kur xhamia u bë magazinë patatesh, në murin e saj shkroi me germa të mëdha “Rroftë Enver Hoxha!”. Kur filluan rropamat e ndërrimit të sistemit shkoi në një kurs tremujor andej nga Plepat e Durrësit, disa thanë për polic, të tjerë për gjykatës, por ai u kthye në fshat me çallmë. Nuk e zgjati shumë, por fshiu emrin e diktatorit dhe në mur, asaj dite e këtej, lexohej “Rroftë Hoxha!”.

Ditët e para njerëzit e morën me të qeshur, por që të premtën e tretë filluan të bëhen seriozë, kur dëgjonin citatet e reja që ai ua lexonte arabisht dhe shqip.

“Ç’kohë dreqi jetojmë! - mendoi Mirjet Xhiritlia. - Fise, fise, hise, hise.” Dhe kujtoi që shpesh thuhej se fisit të tyre “u kishte rënë për hise” të ishin lajmës për gjëra të këqija e të trishtueshme. Ashtu si edhe të parit të tyre, që kishte shërbyer si kuzhinier i një gjenerali turk në luftën e Kretës. Kur e humbën betejën, gjeneralë të tjerë, nga frika e zemërimit të kryekomandantit, urdhëruan kuzhinierin të kumtonte lajmin e keq. Ai ngeli ngushtë, midis thumbit e patkoit.

“Çfarë do të hani për mëngjes, pashá?”, e pyeti.

“Tirit”, i tha ai.

“Tirit? Allandi Xhirit, - doli menjëherë dhe u përball me gjeneralët e tjerë. - I thashë, ha papare, i thashë, por Kreta ra!”

“Nga ai na mbeti Xhiritlia, - mendoj Mirjeti, - dhe ndoshta mallkimi që të kumtojmë lajme të këqija.”

Petrit Kallabakun e trishtonte çdo takim me fshatarët dhe të njohurit e tij, sepse të gjithë një pyetje i bënin: “Të gjeti motra, ku është ajo tani?”. I dukej sikur kapte ndonjë tel rryme që e dridhte nga maja e flokëve deri në thonjtë e këmbëve.

“Erdhi ky i shkreti, erdhi, por kalin hupë, kërpeshin pru...”, mendonin të tjerët pasi ndaheshin prej tij.

Kështu i ndodhi edhe me Mirjetin, kur në takimin e parë ai e pyeti: “Të gjeti?”.

“As më gjeti dhe as e gjeta, - iu përgjigj ai idhnueshëm. - Botë e madhe, humbet bualli e jo njeriu”, u përpoq të nxirrte një arsye, por ndjeu se kishte thënë një gjë të trashë, pa kuptim dhe asgjë më tepër.

Mirjeti kishte mbetur kallkan.

“Je martuar?”, e pyeti Petriti.

“Jo, ti e di...”

“Mos e prit më, - i tha Petriti. - Nuk e di askush se ku gjendet.” Ai e dinte që motra e tij donte Mirjetin, që kur ishin bashkë në shkollë. Kishte qenë një betim i nënave të tyre, që kur ishin aksioniste në ndërtimin e hekurudhës së Myzeqesë. “Po linda unë vajzë e ti djalë do t’i martojmë”, i patën thënë njëra-tjetrës. Dhe kur ata lindën me pak muaj diferencë, u vunë emra që tingëllonin thujse njëlloj: Mirjet dhe Jetmira. U afruan shumë me njëri-tjetrin që në vegjëli, aq sa njerëzia duke i parë, thoshin: “Janë bërë për njëri-tjetrin”.

Petrit Kallabaku e dinte këtë historizë të motrës së vet me atë djalë të nemitur, që rrinte përballë tij, por nuk e dinte dhe nuk kishte nga ta merrte vesh çfarë shkumbi e kishte përvëlur shpirtin e Mirjetit që atë ditë, që Jetmira kishte marrë udhët e botës për të kërkuar vëllanë. Askujt, as atij vetë, nuk i kishte treguar për rrugën që do të merrte në kërkim të vëllait. Hodhi dy guriçka në dritaren e tij, dhe i bëri shenjë për të shkuar pas saj. U takuan në barnishtën më të afërt. Aroma e barit të tërfiltë, të sapotharë, u përhap nëpër trupat e tyre, që po i zinte një dridhmë e lehtë.

“Do të nisesh”, e pyeti ai.

Ajo nuk foli, u lagurit pak dhe e afroi te vetja, ia mori kokën në gjoksin e saj dhe pas pak ndjeu kërcimin e pullacekes së jelekut, që u këput e humbi mes barit. Këmisha e bardhë u hap dhe ai pa sybishtas dy frutat e tamëlt, që po merrnin një purpur të lehtë si në vesë të



mëngjesit. Pa e ditur se ç'po bënte, mori mes buzëve që i digjeshin dy thithkat, që kishin kërcyer të forta e të skuqura si kokrra thane...

Pas asaj grimëhere, as njëri dhe as tjetra, nuk ishin në këtë tokë dhe as në atë bar të tërfiltë, një dorë e padukshme i ngriti nëpër re dhe lule derisa u dëgjua një ohmë e lehtë dhe virgjëria humbi mes fletëzave të thara të tërfilit e të gjornabutit. Të dy njëherësh menduan se bari mbi të cilin ishin shtrirë kishte filluar të lulëzonte përsëri.

Jetmira u ngrit e para, e puthi epushëm dhjetëra herë në sy, në buzë, në gushë, në duar dhe në gjoks, e puthi me ashk e maraz dhe pastaj u largua pa thënë asnjë fjalë. Ai mbeti edhe pak çaste i shtrirë në bar dhe u kujtua për një këngë labe, që ia kishte mësuar një shok i teknikumit...

*“Kjo këmisha jote, vesë edhe dëborë,  
s'ta heq dot nga trupi se më shkrin në dorë.”*

Të nesërmen i treguan se Jetmira kishte ikur. “U nis të kërkojë vëllanë e vdekur”, i thanë.

“Asnjëherë nuk e takove?”, e pyeti Petritin.

“Edhe ta takoja, kushedi a do ta njihja”, i tha tjetri.

Përbrenda ndjeu një zhigë përvëluese, një dyshim që ia zuri frymën e ia bëri kraharorin shkrumb, por nuk tha asnjë fjalë. Dhe nuk kuptoi pse në atë çast harroi edhe të fliste. “Kushedi a do ta njihja... kushedi a do ta njihja”, përsëriste fjalët e Petritit sikur do të zgjidhte një lëmsh të ngatërruar.

“Sa mirë do të ishte sikur të mos e hapnin atë arkivol, - mendoj njëgrimë, - nuk do të shkonte Jetmira e shkretë për të kërkuar këtë zdap, që nuk e di se çfarë flet.”

Tjetri e pa me dhimbje dhe u largua.

\* \* \*

Kur u nda nga Mirjeti, nuk dinte më ku të shkonte dhe këmbët vetvetiu e shpunë drejt shtëpisë së vet.

Kosovarja, që i tregoi se e quanin Drena, e priti me dashamirësi. Kur e pa që ai po rrinte si në gjemba, vuri menjëherë xhezven në prush për t’i pjekur kafë. As ajo vetë nuk e kuptonte, pse kishte një kureshtje të papërballueshme për ta pyetur për jetën e tij, duke menduar se ashtu si ajo, edhe ai do të kishte rrëpira e mjegullnajë, që e bënin gjithnjë të trishtë e fjalëpakë. Të dy ishin të etur për diell. Edhe atë ditë, derisa u poq kafja, ai nuk foli, por edhe Drena nuk e trazoi.

“Ku është ajo tjetra?”, pyeti dhe filloi të gjerbte kafënë, por paksa ngutshëm, sikur donte ta mbaronte me një frymë.

“Po rregullon dhomat”, i tha Drena.

“Qëndroni këtu në shtëpinë time, unë po rri andej nga xhaxhai. Kushedi a do të rri shumë”, tha në fund, por Drena e kuptoi se ai e la përgjysmë atë që do të thoshte.

“Me motrën a u takove?”, pyeti pa kuptuar se kishte shkëlur në minat e zemërimit të tij.

“Çfarë ju ka gjetur të gjithëve me motrën time?”